

RAPORTI I PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar

Kosovë

Fuqizimi i Sekretariatit për Administratën Publike

CNTR 07 7878 / KOS0702E

20 nëntor 2007

Coffey International Development Ltd

The Malthouse 1 Northfield Road Reading Berkshire RG1 8AH
United Kingdom

T (+44) (0) 1189 566 066 F (+44) (0) 1189 576 066

www.coffey.com.au/internationaldevelopment

Registered Office: 1 Northfield Road Reading Berkshire RG1 8AH United Kingdom
Registered in England No. 3799145 Vat Number: GB 724 5309 45

PËRMBAJTJA

1	MIRËNJOHJE.	1
2	PROJEKTI	1
3	PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA	2
3.1	Detyra dhe dalurat 1: Mbështetje Drejtorit të DASHC që të komplotojë shqyrtimin organizativ të Departamentit dhe të zhvillojë strukturë të revizuar, të krijojë përgjegjësitë e tij për udhëheqje dhe menaxhimin e implementimit të Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit.	2
3.2	Detyrat dhe Rezultati 2: Bashkë me DASHC, përkrahë Ministritë, Agjencive dhe organet tjera implementuese që të zhvillojnë programet punuese të detajuara për secilin aktivitet prioritar në Planin e Veprimit të RAP.	3
3.3	Detyra dhe të dalurat 3: Përkrahja me themelimin e Grupit Punues të Reformës së Administratës Publike dhe mbështetja në funksionet e sekretariatit të tij brenda DASHC. Zhvillon procedurat dhe sistemet për GPRAP që në mënyre efikase të paraqesë termet e tij të referencës për të udhëhequr, monitoruar dhe për ti raportuar Qeverisë për progresin mbi implementimin e Planit Veprues të RAP përmes procedurave të Planit Veprues të Partneritetit Evropian të administruara Agjencia për Integrim Evropian	4
3.4	Detyra dhe të dalurat 4: Përkrahja e Grupit të Ekspertëve për Reformën e Administratës Publike (GERAP) në përkrahjen e tij për strategjinë dhe implementimin e RAP dhe Planit të Veprimit; dhe në veçanti, dispozitat e tij në ekspertizën teknike dhe udhëzimi në objektivat dhe qëllimet për arritjen e ndryshimeve.	6
3.5	Detyra dhe të dalurat 5: Mbështetja e Zëdhënësit të Ministrisë së Shërbimeve Publike për të zhvilluar dhe implementuar publikimin dhe strategjinë e komunikimit për të promovuar strategjinë e RAP dhe objektivat e tij përtej administratës publike dhe shoqërisë civile, biznesit dhe njerëz të përgjithshëm.	6
3.6	Detyra dhe të dalurat 6: Organizimi dhe trajnimi i punëtorive dhe ngjarjeve të ngjashme për zyrtarët në DASHC, Ministria e Shërbimeve Publike, dhe organizatave implementuese për çështje të ndryshme, për shembull; zhvillimi i programeve të punës dhe implementimi, monitorimi dhe raportimi, etj.	7

PËRMBAJTJA

3.7	Detyrat dhe të dalurat 7: Organizimi i takimeve të nevojshme, informimi i kryesuesit i takimeve të tilla dhe regjistrimi i rezultateve kryesore.	8
4	REZULTATET KRYESORE TË ARRITURA	8
5	REKOMANDIMET PËR AKTIVITETET E ARDHSHME TË QEVERISË	9

Ky raport është përgatitur për DFID nga konsulentët të punësuar nga Coffey International Development nëpërmjet kornizës Economist Resource Centre. Pikëpamjet e theksuara këtu janë ato të autorëve dhe nuk e përfaqësojnë pikëpamjet e Coffey International Development, DFID, apo partnerëve të ERC

SHKURTESAT & AKRONIMET

AIE	Agjensioni për Integritet Evropian
FNK	Fondi i Ndërtimit të Kapaciteteve
DASHC	Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtarë
DFID-RAP	Ekipi Mbështetës I DFID për Reformën e Administratës Publike
DMKRAP	Divizioni për Menaxhim dhe Koordinimin e Reformës në Administratën Publike
KE	Komisioni Evropian
PVPE	Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian
UE	Bashkimi Evropian
PSHFDIM	Projekti për Shqyrtim Funkcional dhe Dizajn Institucional të Ministrive
GERAP	Grupi i Ekspertëve mbi Reformën në Administratën Publike
MRH	Menaxhmenti i Resurseve Humane
IPA	Instrument Përkrahje para-hyrjes
PSZHK	Plani Strategjik Zhvillimor Kosovar
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur – Fondacioni SOROS
KIPA	Instituti Kosovar për Administratë Publike
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MPS	Ministria e Shërbimeve Publike
OPM	Zyra e Kryeministrit
RAP	Reforma e Administratës Publike
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
Nën-GPRAP	Nën-Grupet Punuese në Reformën e Administratës Publike
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

SHKURTESAT & AKRONIMET

UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administrim të Përkohshëm në Kosovë
KSKB	Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
GPRAP	Grupi Punues i Reformës në Administratën Publike

1 MIRËNJOHJE.

Coffey International Development Limited i është mirënjohës Departamentit për Zhvillim Ndërkombëtar të Qeverisë Britanike (DFID), Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP) dhe Qeverisë së Kosovës për mundësinë që patëm për të përkrahur zhvillimin dhe implementimin e programit shumë të rëndësishëm të Reformës së Administratës Publike në Kosovë.

Coffey International Development Limited, e posaçërisht ekipi i konsulentëve, do të dojë të shënojë falënderimet dhe mirënjohjet e tyre Ministrit, zyrtarëve dhe ekspertëve në MSHP; Drejtorit dhe stafit të Departamentit të Administratës së Shërbimit Civil(DASHC); anëtarëve të Grupit të ekspertëve të Reformës në Administratën Publike (GERAP) dhe të gjithë të tjerëve të përfshirë në projekt, për mirëpritje pozitive dhe bashkëpunim të ngushtë në të cilën kemi hasur gjithandej. Duhet shtuar këtu edhe mbështetjen e mirë administrative dhe TI nga ana e MSHP e cila ishte e pa çmueshme në hapjen dhe udhëheqjen e zyrës së projektit brenda selisë qendrore të Ministrisë.

2 PROJEKTI

Ky projekt ishte i fundit nga seria e kontraktimeve të financuara nga ana e DFID për të mbështetur Qeverinë Kosovare në zhvillimin e saj dhe iniciativën dhe implementimin e programit mbarë qeveritarë të Reformës së Administratës Publike. Vjen pas një numri të projekteve paraprake në 2006 dhe 2007 poashtu të financuara nga ana e DFID për mbështetje të MSHP në krijimin dhe zhvillimin e Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit.

Pas kërkesës së Zonjës Tërmkolli, Ministre e Ministrisë së Shërbimeve Publike, për mbështetje të vazhdueshme, kërkesë kjo e mbështetur nga ana e Udhëheqësit të GERAP, DFID pranoi të financoj ekipin me orar të plotë I përbërë nga një konsulent ndërkombëtarë dhe tre konsulent Kosovarë në afat gjashtë mujorë-15 Maj 2007 deri më 15 Nëntor 2007. Më vonë, data përfundimtare u shty për dy javë deri me 30 Nëntor që të maksimalizohet mbështetja ndaj Ministrisë brenda buxhetit origjinal të kontraktuar.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që të mbështesë implementimin në shtigjet fillestare të Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit, i cili ishte aprovuar nga ana e Qeverisë së Kosovës më 21 Mars 2007. Mbështetje do duhej që të dërgohej përmes një procesi ehe koordinojë implementimin e Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit.

Qëllimi I Ekipit Mbështetës të DFID-RAP nuk ishte që të siguroj zgjidhje të gatshme, pasi që kjo nuk do të përputhej me kërkesat reale të Administratës publike Kosovare. Në vend të kësaj , Ekipi Mbështetës I DFID-RAP propozoi që duke përdorur konsulentët e vet në bashkëpunim me Shërbyesit Civil Kosovar në DASHC dhe MSHP, të zhvillojë sistemin e ri dhe procese specifike kundrejt nevojave të Administratës Kosovare, por gjithmonë duke u bazuar në eksperiencën dhe praktikën më të mira nga vendet e ndryshme.

Kjo metodë do të prodhonte sisteme dhe procese që do të ishin specifike për kërkesa, kulturë dhe ambientin e punës në Kosovë; dhe tërësisht ishte në vijën e qëllimeve origjinale të Ministrit të MSHP që të krijojë dhe të implementoj Strategjinë e RAP duke përdorur eksperiencën dhe aftësitë e Kosovarëve në vend të konsulentëve ndërkombëtarë.

Gjithmonë ka qenë e qartë se kjo do të kërkojë përkushtim të madh nga ana e Shërbyesve Civil Kosovar për sa i përket si kohës së tyre ashtu edhe përfshirjes praktike të tyre. Andaj për Ekipin Mbështetës të DFID-RAP ka qenë zhgënjyes fakti se stafi kyç - Drejtori I DASHC dhe stafi i Divizionit të

ri për Menaxhim dhe Koordinim të Reformës së Administratës Publike (DMKRAP)- I cili do të vazhdoj të jetë përgjegjës për koordinimin dhe ecje përpara të implementimit të Planit për Veprim të RAP ish-in të emëruar në postet e tyre në fazën e vonshme të projektit-respektivisht më 1 Tetor dhe 1 Nëntor 2007 . Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të DASHC dhe stafi ekzistues në Divizione tjera brenda DASHC, siguruan burime esenciale me qëllim të arritjes së progresit. Sidoqoftë, kjo ishte punë ishte në vazhden e punëve ekzistuese të tyre dhe ishte e ditur që nga fillimi se aranzhimi ishte i përkohshëm.

Menaxhmenti strategjik i projektit qëndroi gjatë gjithë kohës me Ministrin e Shërbimeve Publike dhe Drejtorin e DASHC; dhe Ekipi Mbështetës i DFID-RAP i përgjigjej kërkesave dhe vendimeve të tyre për mbështetjen e kërkuar.

3 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA

Progresi ishte realizuar në të shtatë “ Detyrat dhe dalurat” të definuara në termat e referencës të kontratës. Përmbledhja e aktiviteteve specifike të ndërmarra dhe të dalurave të dërguara janë të detajuara në vijim.

3.1 Detyra dhe dalurat 1: Mbështetje Drejtorit të DASHC që të kompletojë shqyrtimin organizativ të Departamentit dhe të zhvillojë strukturë të revizuar, të krijojë përgjegjësitë e tij për udhëheqje dhe menaxhimin e implementimit të Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit.

Si aktivitet të tij të parë kryesorë, Ekipi Mbështetës i DFID-RAP zbatoi retrospektivë të gjithanshme të DASHC dhe resurseve e përgjegjësi të tij ekzistuese, dhe së bashku me Ushtruesin e Detyrës së Drejtorit të DASHC ia publikoi propozimin e detajuar Ministres Tërmkollit, Ministres së Shërbimeve Publike, dhe Sekretarit Permanent të MSHP duke rekomanduar krijimin e Divizionit të ri prej 4 anëtarëve brenda DASHC. Divizioni i quajtur më vonë Divizioni për Menaxhim dhe Koordinim të Reformës në Administratën Publike (DMKRAP), për specifikë kishte menaxhimin, koordinimin dhe monitorimin e implementimit të Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit të aprovuar nga Qeveria në Mars 2007, dhe të sigurojë Sekretariat Grupit Punues mbi RAP (GPRAP) që kur ishte formuar.

Propozimet u aprovuan nga ana e Ministres Tërmkollit në Qershor të 2007, siç u aprovua edhe rekrutimi i Shefit të Divizionit dhe i dy Zyrtarëve të Lartë që të krijohet DMKPAR i ri brenda DASHC. Nga Ekipi Mbështetës i DFID-RAP u kërkua që në mënyrë të përpiloh draftin e detajuar sipas termave të referencës, përshkrimin e punës e tij për secilën pozitë, të cilat u aprovuan dhe u përdorën gjatë rekrutimit, selektimit dhe emërimit të tre zyrtarëve, edhe pse kjo nuk u përmbyll nga ana e MSHP deri më 1 Tetor 2007.

Pasi që procesi i rekrutimit ishte paraparë të zgjasë disa muaj, Ministria vendosi që stafi ekzistues brenda DASHC përkohësisht të marr mbi vete përgjegjësi për aktivitetet e implementimit të Planit për Veprim të RAP, dhe kërkoi nga Ekipi i DFID-RAP që t’iu ndihmojë këtyre zyrtarëve. Në veçanti, Ekipi i DFID-RAP stafit ekzistues të DASHC i siguroi mbështetje në ndërtim të kapaciteteve në zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive në koordinim dhe menaxhim të projektit. Kjo përfshiu edhe dërgimin e trajnimit për stafin menaxhues të DASHC në rolet e tyre të menaxhimit dhe koordinimit të implementimit të Planit për Veprim të RAP; dhe në shndërrimin e strategjisë në veprime dhe aktivitete kuptimplota.

Për shkak se shkathtësitë teknike ekzistuese në DASHC të përshtatshme për këto përgjegjësi të shtuara, diskutimet mes anëtarëve të GERAP dhe Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të DASHC ngriti mundësinë që Ministria të kërkojë mbështetje afatgjate shtesë të financuar nga jashtë. Ekipi

Mbështetës të RAP iu kërkua që të hulumtojnë mundësinë në kërkim të një këshilltari të shkathët ndërkombëtarë nga Fondi për Ndërtim të Kapaciteteve (FNK) të UNDP-KFOS i cili personalisht do të ndihmojë Drejtorin të DASHC, sidomos kur edhe Kryeministri i kishte inkurajuar të gjitha Ministrinë të përfitojnë më shumë nga ky program i financuar nga ndërkombëtarët. Ide e përgjithshme ishte që Këshilltari nga FNK dhe Ekipi Mbështetës i DFID-RAP do të kompletojnë njëri tjetrin - nga Këshilltari i FNK duke i siguruar Drejtorit të DASHC këshilla nga dita në ditë, kurse nga ana e Ekipit Mbështetës t'u sigurohet Udhëheqësve të katër Divizioneve të DASHC dhe stafit të tyre mbështetje implementuese praktike. Bazuar në rezultatet e veta kërkimore Ekipi Mbështetës i DFID-RAP i paraqiti UD së Drejtorit të DASHC kërkesën e detajuar dhe termat e referencës të cilat Ministria do duhej ti paraqesë Bordit të Projektit të FNK po që se do të kërkonte asistencë të tillë.

UD së Drejtorit i paraqiti Sekretarit Permanent të MSHP draftin final, i cili u pajtua se idea për Këshilltarin e FNK ishte e qëlluar dhe ashtu siç duhet autorizoi dhe i paraqiti kërkesën Koordinatorit të Projektit të FNK. Në Korrik të 2007, Bordi i Projektit të FNK aprovoi financimin e një Këshilltari që të mbështesë Drejtorin e DASHC, me theks të veçantë në përgjegjësitë implementuese të DASHC në RAP. Fatkeqësisht, identifikimi, përzgjedhja dhe emërimi i Këshilltarit mori më shumë kohë se sa që fillimisht ishte paraparë dhe ai filloi me punë në MSHP më 1 Nëntor të 2007.

Për shkak të kohës më të gjatë se që ishte e paraparë për emërimet të personelit punëtorëve të ndryshëm kyç, përfshirë këtu edhe Drejtorin e përhershëm të DASHC, Ekipi Mbështetës i DFID-RAP identifikoi shtigjet përmes së cilave do të maksimizohet efektiviteti i hershëm i këtyre individëve posa të fillonin me punë. Në veçanti, pakoja e trajnimit hyrës u zhvillua nga ana e Ekipit së bashku me UD e Drejtorit të DASHC dhe shefat e Divizioneve të DASHC. Pakoja e informacioneve dhe mbështetja u pranua mirë nga ana e stafit të ri të DMKRAP dhe më pastaj u përdorë nga DASHC në programin induktiv të zyrtarëve tjerë të ri në MSHP. Pakoja u zhvillua gjatë diskutimeve me Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP) dhe Zyrës Ligjore të MSHP që të sigurohej përshtatshmëria e pakos me planin e trajnimit induktiv ekzistues për të gjithë shërbyesit e ri civil.

Trajnimi specialist shtesë i kërkuar nga stafi i DMKRAP u identifikua gjithashtu, përfshirë shembujt si: roli dhe procedurat e MSHP, DASHC dhe të DMKRAP; përmbajtja e Strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit; dhe implementimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit përmes GPRAP dhe Nën-GPRAP. Këto kërkesa u përmbushën me anë të këshillimit dhe mekanizmave tjerë mbështetës që në mënyrë të drejtpërdrejtë iu sigurova zyrtarëve të DMKRAP nga resurset e Ekipit Mbështetës të DFID-RAP.

3.2 Detyra dhe të dalurat 2: Bashkë me DASHC, përkrahë Ministrinë, Agjencive dhe organet tjera implementuese që të zhvillojnë programet punuese të detajuara për secilin aktivitet prioritar në Planin e Veprimit të RAP.

Për shkak se stafi i ri i DMKRAP nuk ishte në pozitë deri më 1 Tetor, mbështetja të cilën Ministria do të jepte në implementimin e Planit të Veprimit të RAP në katër muajt a parë të projektit ishte nga resurset ekzistuese të DASHC. Kjo punë ishte shtesë në përgjegjësitë e tyre ekzistuese për pagesë, aktivitetet e menaxhmentit të personelit dhe burimeve njerëzore (MBH), dhe si rezultat DASHC ishte fokusuar kryesisht në themelimin e GPRAP dhe Nën-GPRAP, dhe sekretariatet e tyre që mbetën të burime ose mundësi me qëndrueshmëri të kufizuara për të punuar me të gjitha Ministrinë.

Që nga emërimi i Shefit dhe stafit për të krijimin e DMKRAP të ri, ka pas një zgjerim të madh në mbështetje të ministrive dhe agjencive. DMKRAP i përkrahur edhe nga Ekipi Mbështetës i DFID-RAP tani më është takuar me të gjitha ministrinë dhe secila e ka emëruar Koordinatorin e RAP që të punojë

bashkërisht me DMKRAP që të sigurojë që programet punuese të organizatave të tyre përfshijnë kërkesat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të RAP. Ekipi Mbështetës i DFID-RAP i paraqiti Shefave të DMKRAP draftin e termeve të referencës për përgjegjësitë e Koordinatorëve të RAP nëpër Ministri. Programi për të zhvilluar rrjetin e këtyre RAP Koordinatorëve të ministrive dhe për DMKRAP të sigurojë burime të rregullta të informacioneve dhe monitorim, është zhvilluar me ndihmën e Ekipit Mbështetës të DFID-RAP.

Puna e mëtutjeshme tash më është planifikuar për secilën ministri të caktoj individin për secilën nga gjashtë fushat e interesit të Nën-GPRAP që të mbështesë RAP Koordinatorët e ministrive të tyre në këto fusha specialiste. DMKRAP shkurtimisht do të zhvillojë dhe furnizojë me informacione dhe udhëzime për këto përgjegjësi.

Pas vendimit të Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) në Gusht të 2007, pika e përhershme në progresin e implementimit të Planit Veprues të RAP iu shtua agjendës së takimeve javore të gjithë Sekretarëve Permanent. Kjo është një mundësi ideale që të angazhojë ministrinë përmes shërbyesve më të lartë civil të tyre, dhe tash Shefi i DMKRAP e informon Sekretarin Permanent të MSHP mbi progresin dhe për ndonjë çështje të implementimit para çdo takimi.

Nëse kërkohet nga MSHP ose GERAP, Ekipi Mbështetës i DFID-RAP ka hartuar "plane" të ndryshme të Plan Veprimit të RAP- s.p.sh: veprimet për tu kompletuar në gjashtëmujorin e dytë të 2007; buxhetet e vlerësuara për veprime nga ana e ministrive përkatëse etj. Ekipi gjithashtu ka përpiluar më shumë tabela kohore të detajuara me aktivitete për muaj ose periudha të veçanta që tregojnë p.sh: takimet e GPRAP ose kohën e caktuar për përpilim të raporteve

3.3 Detyra dhe të dalurat 3: Përkrahja me themelimin e Grupit Punues të Reformës së Administratës Publike dhe mbështetja në funksionet e sekretariatit të tij brenda DASHC. Zhvillon procedurat dhe sistemet për GPRAP që në mënyre efikase të paraqesë termet e tij të referencës për të udhëhequr, monitoruar dhe për ti raportuar Qeverisë për progresin mbi implementimin e Planit Veprues të RAP përmes procedurave të Planit Veprues të Partneritetit Evropian të administruara Agjencia për Integrim Evropian

Me kërkesën e Zyrës së Ministrisë për Shërbime Publike, Ekipi Mbështetës i DFID-RAP paraqiti draftin e Vendimit të Qeverisë për themelimin e Grupit Punues për Reformën e Administratës Publike (GPRAP), përfshirë anëtarësinë, termet e referencës, procedurat e punës e tjera, si dhe letrën që prezanton draft dokumentin dhe propozimi që i bëhet Kryeministrit dhe Qeverisë. Dokumentet, në tri gjuhë zyrtare, u nënshkruan nga Ministria Tërmkollit më 14 Qershor , dhe Qeveria e Kosovës në takimin e saj më 20 Qershor 2007 aprovoi themelimin e GPRAP.

Për shkak të rrethit të gjerë të subjekteve të mbuluara nga Strategjia e PVRAP, me vendimin e Qeverisë GPRAP është autorizuar krijimi i Nën-Grupeve Punuese (Nën-GPRAP) sipas kërkesës, që të sigurojnë implementim të qetë të secilës fushë së veçantë. Ekipi Mbështetës i DFID-RAP e paraqiti draftin e termeve të referencës dhe procedurat operacionale për secilën Nën-GPRAP të propozuar Ministres Tërmkollit, të cilat ajo edhe i aprovoi. Ekipi Mbështetës i DFID-RAP mori pjesë në diskutimet mes MSHP, GERAP dhe Agjencinë Evropian për Integrim (AEI) për hapat konkretë që duhet ndërmarr për të lansuar GPRAP dhe gjashtë Nën-GPRAP. Në veçanti, kjo përfshinë identifikimin e anëtarëve të përgjithshëm dhe individë specifik për secilin komision.

Në mënyrë që të lansojë, themelojë dhe ta bëjë funksionale GPRAP dhe Nën-GPRAP si dhe ti inkuadrojë të gjithë Sekretarët Permanent dhe Shefat Ekzekutiv të Agjencive në RAP dhe projektet Përmbledhëse Funksionale, Ministria dhe GERAP-i mbajtën një seminar në Ohër në fund të muajit Gusht 2007.

Ekipi mbështetës i DFID-RAR plotësisht ka mbështetur kabinetin e Ministres Tërmkollit dhe Sekretarin Permanent të MSHP-së me planifikimin dhe zhvillimin e kësaj punëtore. Kjo përfshiu: draftimin e ftesës dhe agjendën; draftimin e prezantimeve për Këshilltaren e Lartë Politike, Sekretarin Permanent, Ushtruesin detyrë të Drejtorit të DASHC, Udhëheqësit të GERAP; duke dhënë mbështetje logjistike dhe të gjitha përkthimet e dokumenteve dhe përkthimin simultant (3 gjuhë); akomodimi i seanceve të grupeve punuese; dhe, bërjen e prezantimit për faktorët e suksesit dhe shmangja e barrierave për ndryshim.

Pas kësaj punëtore, dhe sipas kërkesës së këshilltares së lartë politike të Ministres Tërmkollit, Ekipi mbështetës i DFID-RAP po ashtu ka marrë pjesë në takimin e përbashkët të Ministrisë me anëtarët e GERAP, GPRAP, dhe DASHC me 31 Gusht 2007. Takimi ishte aranzhuar për të finalizuar çështjet praktike për të arritur implementimin e GPRAP dhe nën-grupet punuese siç është pajtuar në Ohër.

Sipas kërkesës së Sekretarit Permanent, në rolin e tij të kryesuesit të GPRAP, ekipi mbështetës i DFID-RAP ka bërë kornizën raportuese për nën-grupet punuese dhe udhëzimet për përdorimin e tij, një model për procesverbalin e takimeve dhe letrën për Sekretarin Permanent për ti dërguar koordinatorëve të nën-grupeve punuese.

GPRAP siguron progres raportin për implementimin e strategjisë së RAP dhe planit të veprimit nëpërmjet Ministres Tërmkollit tek Qeveria e Kosovës, dhe nëpërmjet Agjencisë për Integritet Evropian (AIE) tek Komisioni Evropian (KE) për Planin e veprimit për Partneritetin Evropian PVPVE lidhur me veprimet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) për veprimet në Standardet për Kosovën. Ekipi mbështetës i DFID-RAP ka bërë ndërlidhje me AIE dhe MSHP-në për të siguruar kornizën raportuese ndesh me kërkesat e këtyre kërkesave të ndryshme raportuese.

Si pjesë e asistencës për DASHC të ekipit mbështetës të DFID-RAP, ekipi ka dhënë asistencë për zhvillimin e shërbimeve të Sekretariatit për GPRAP dhe nën-grupeve punuese. Kjo përfshiu ndihmën e DASHC për të krijuar agjenda standarde dhe dokumente tjera; raporte për komisionin dhe prezantimet; dhe për të krijuar dhe qarkulluar procesverbalet dhe raportet e konsoliduara në formate standarde. Deri në caktimin e Drejtorit Permanent të DASHC dhe stafit të DMKRAP, stafi ekzistues i DASHC ishte disa herë i stërngarkuar për të bërë një Sekretariat efektiv për GPRAP dhe gjashtë nën-grupet punuese.

Takimi i parë i GPRAP është mbajtur me 15 Tetor 2007, është paraprirë nga takimet e të gjithave gjashtë nëngrupeve punuese të cilat kanë kompletuar rishikimin e pozicionit të tanishëm për implementimin e Planit të Veprimit të RAP. Ekipi mbështetës i DFID-RAP ka mbajtur të gjitha takimet e GPRAP dhe nëngrupeve punuese dhe ka ndihmuar stafin e DASHC i cili ka siguruar shërbime të sekretariatit.

Ekipi mbështetës i DFID-RAP po ashtu ka mbështetur Sekretarin Permanent të MSHP-së, në rolin e tij si kryesues i GPRAP, në takimin me Sekretariatin e Planit të Zhvillimit të Strategjisë të Kosovës (KDSP) nga departamenti makro-ekonomik në Ministri të Financave dhe Ekonomisë (MEF). Takimi ishte mbajtur për të siguruar kërkesat financiare për aktivitetet e relevante në Planin e Veprimit të RAP për 2008 deri 2011 ishin të përfshira në buxhetin e Qeverisë së Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtar.

3.4 Detyra dhe të dalurat 4: Përkrahja e Grupit të Ekspertëve për Reformën e Administratës Publike (GERAP) në përkrahjen e tij për strategjinë dhe implementimin e RAP dhe Planit të Veprimit; dhe në veçanti, dispozitat e tij në ekspertizën teknike dhe udhëzimi në objektivat dhe qëllimet për arritjen e ndryshimeve.

Ekipi mbështetës i DFID-RAP po ashtu ka marrë pjesë në takimin e Grupit të Ekspertëve për Administratën Publike (GERAP) me 31 Maj 2007. Në takim janë miratuar përgjegjësit individuale të anëtarëve të GERAP dhe rolin e ekspertëve teknik që ata do ta përmbushin për të asistuar DASHC dhe GPRAP dhe nën-GRRAP, MSHP dhe organizata tjera implementuese.

Takimi pasuese i GERAP dhe DASHC të Shtunën me 30 Qershor po ashtu ishte i përkrahur nga DFID-RAP, e cila është mbajtur për të diskutuar dhe miratuar anëtarësinë kryesore, termat e referencës dhe procedurat operative të GPRAP dhe nën GPRAP, dhe në veçanti rolet në vazhdim të anëtarëve të GERAP. Sipas kërkesës së Këshilltares së lartë të Ministres, Ekipi mbështetës i DFID-RAP ka krijuar një numër dokumentesh për takimin përfshirë edhe organogramin e përgjithshëm për të treguar qartë organizatat e përfshira në tërë procesin dhe marrëdhëniet e tyre dhe rolet.

Ekipi mbështetës i DFID-RAP është takuar rregullisht me anëtarët individual të GERAP për të identifikuar barrierat e mundshme për implementimin dhe për të propozuar veprime të mundshme pozitive që mund të ndërmerren për ti kaluar këto. Një fillim është bërë për të zhvilluar një marrëdhënie të ngushtë punuese mes anëtarëve të GERAP dhe DASHC me një takim të përbashkët të kryesuar nga MSHP me 18 Qershor. Megjithatë, tash pasi që DMKRAP është duhur të bëhen përpjekje më të tutjeshme për të themeluar dhe zhvilluar këtë marrëdhënie esenciale si një proces efektiv për dy mënyra komunikimi dhe shpërndarja e ideve dhe informatave.

MSHP dhe GERAP ka mbajtur disa takime tjera në të cilat gjithmonë kanë thirrur ekipin mbështetës të DFID-RAP, përfshirë at me 27 Korrik 2007. Kjo ishte kryesisht për projektin e HELM/CPM për të prezantuar idetë e tyre primare për menaxhimin dhe strukturën operative që MSHP-ja duhet të themelojë për implementimin e projektit të Rishikimit Funkcional- FRIDOM. Pas disa diskutimeve është miratuar në parim projektet e RAP dhe FRIDOM do të duhej të përdornin struktura dhe stafin e njëjtë. Kështu që të dy projektet e financuara nga DFID do të menaxhohen dhe monitorohen nga GPRAP dhe nën -GPRAP, dhe mbajnë lidhje me MSHP dhe ekipin e HELM/CPM do të bëhet nëpërmjet DMKRAP në DASHC.

3.5 Detyra dhe të dalurat 5: Mbështetja e Zëdhënësit të Ministrisë së Shërbimeve Publike për të zhvilluar dhe implementuar publikimin dhe strategjinë e komunikimit për të promovuar strategjinë e RAP dhe objektivat e tij përtej administratës publike dhe shoqërisë civile, biznesit dhe njerëz të përgjithshëm.

Nga MSHP është organizuar një fushatë informative një mujore në Maj 2007 për Reformën e Administratës e financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ekipi mbështetës i DFID- RAP ka përkrahur zëdhënësin e Ministres për Shërbime Publike në disa aktivitete lidhur me këtë fushatë.

Ekipi mbështetës i DFID-RAP po ashtu ka mbështetur MSHP duke draftuar termat e referencës për një tender komercial për krijimin dhe operimin e një forum diskutimit online për RAP. MSHP dhe GERAP

kanë planifikuar të lansojnë këtë forum si mënyrën e informimit dhe për të kërkuar sugjerime nga njerëzit dhe shërbyesit civil për Strategjinë e RAP dhe objektivat e tij.

Sipas kërkesës së u.d të Drejtorit të DASHC ekipi mbështetës i DFID-RAP ka draftuar një broshurë për të promovuar shërbimet e DASHC. Broshura do të shërbejë për të rritur dhe kuptuar ndërmjet shërbyesve civil dhe përgjegjësive dhe aktiviteteve të DASHC dhe MSHP në lidhje me shërbimin civil dhe administratën publike, programi i reformës dhe kërkesat për ndryshim të nxjerra nga procesi të integritit të EU-së. Teksti i broshurës dhe dy propozime dizajni profesionale janë draftuar dhe dorëzuar tek Drejtori i DASHC dhe Kryesuesit e katër divizioneve të DASHC për vëmendje të tyre.

3.6 Detyra dhe të dalurat 6: Organizimi dhe trajnimi i punëtorive dhe ngjarjeve të ngjashme për zyrtarët në DASHC, Ministria e Shërbimeve Publike, dhe organizatave implementuese për çështje të ndryshme, për shembull; zhvillimi i programeve të punës dhe implementimi, monitorimi dhe raportimi, etj.

Një varg seanca trajnimesh dhe punëtorive ishin bërë nga ekipi mbështetës i DFID-RAP gjatë periudhës së projektit. Të gjitha këto ishin krijuar sipas kërkesës së MSHP, zakonisht nga Këshilltarja e lartë politike e Ministres së Shërbimeve Publike apo u.d të Drejtorit të DASHC, dhe ka përfshirë për shembull:

- Krijimin dhe zhvillimin e strategjisë për stafin e DASHC.
- Zhvillimin e planit të veprimit nga strategjia për stafin e DASHC.
- Transformimi i strategjisë në veprime konkrete dhe aktivitetet për stafin e DASHC.
- Rolet dhe përgjegjësit e DASHC në menaxhimin, koordinimin dhe monitorimin e implementimit të strategjisë së RAP dhe Planit të Veprimit për stafin e DASHC.
- Identifikimi i barrierave tipike për ndryshim dhe si të gjinden zgjidhjet për grupin e GERP dhe MSHP.
- Siguruar implementimin e strategjisë është sukses për të gjithë Sekretarët Permanent dhe Kryeshefat Ekzekutive , mbuluar faktorët e suksesit, për ti tejkaluar barrierat për ndryshim, duke vendosur indikatorët dhe monitoruar dhe raportuar progresin.
- Një paket trajnimi hyrës për anëtarët e rinj për Kryesuesin dhe stafin e DMKRAP.

Si shtesë një numër i trajnimeve të punëtorive është identifikuar dhe agjendat dhe prezantimet janë draftuar për DASHC për të prezantuar pas përfundimit të kontratës së ekipit mbështetës të DFID-RAP. Këto kanë përfshirë:

- Një punëtor për të informuar koordinatoret e RAP në këto ministri me strukturat e përfshira në implementimin e strategjisë dhe Planit të veprimit të RAP dhe përgjegjësit e tyre personale.
- Takimi i ardhshëm tremujor i DASHC për të nxituar Forumin e Menaxherëve të Personelit prej të gjithave Ministrive dhe Komunave. Qëllimi i këtij takimi për Forumin pritet të jap mundësi për DASHC për të prezantuar informatat në një numër e iniciative të reja(p.sh Ligji i ri për Shërbimin Civil dhe projektet e RAP dhe FRIDOM), dhe për Menaxherët e Personelit për të shkëmbyer informata dhe ide në fushat e zakonshme problematike.

Kur është kërkuar, ekipi mbështetës i DFID-RAP po ashtu ka zhvilluar dhe kontribuar trajnime dhe prezantime për konferenca për administratën publike dhe çështjet e reformës janë dorëzuar nga një numër i zyrtarëve Kosovar përfshirë Këshilltaren e lartë politike e Ministres së Shërbimeve Publike, Sekretarin Permanent të MSHP, dhe u.d të drejtorit të DASHC.

Të gjitha materialet për trajnim, agjendat dhe prezantimet ishin përkthyer nga Ekipi mbështetës i DFID-RAP në tri gjuhë zyrtare- Shqip, Serbisht dhe Anglisht. Të gjitha prezantimet dhe trajnimet e dorëzuara nga ekipi mbështetës i DFID-RAP ishin gjithmonë të përcjellur me përkthim simultant në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

3.7 Detyrat dhe të dalurat 7: Organizimi i takimeve të nevojshme, informimi i kryesuesit i takimeve të tilla dhe regjistrimi i rezultateve kryesore.

Sipas kërkesës së MSHP, GERAP, DASHC, etj, ekipi mbështetës i DFID-RAP, ka organizuar dhe/apo përkrahur një varg takimesh të vogla dhe punëtori dhe konferenca të gjëra. Ekipi po ashtu ka krijuar draftime të ndryshme gjithëpërfshirëse dhe dokumente administrative, raporte dhe procesverbale kur iu është kërkuar.

Për shembull: me 23 Tetor 2007 MSHP ka organizuar konferencën për “ Administrata Publike dhe Roli i Grave”. Ekipi ishte pyetur nga Këshilltarja e lartë politike e Ministres Tërmkollit të mbështetës atë në çështjet e administrative dhe të organizimit përfshirë shërbimin për përkthim simultant (Shqip-Anglisht).

Në shtator 2007, ekipi mbështetës i DFID-RAP ka draftuar prezantimet për ‘Politolizimi i Shërbimit Civil në Kosovë’ për u.d të Drejtorit për DASHC për konferencën rajonale në Podgoricë, Mal të zi e organizuar nga UNDP me 11-12 Shtator 2007.

Dhe sipas kërkesës së Këshilltares së lartë të Ministres Tërmkollit në fund të Shtatorit 2007, Ekipi mbështetës i DFID-RAP ka hulumtuar dhe draftuar një raport për analizën e progresit të arritur për RAP nga vendet e Ballkani Perëndimor në krahasim me Kosovë.

Ekipi mbështetës i DFID-RAP ka pasur një numër takimesh me Udhëheqësin e ekipit dhe konsulentët kryesor nga Korporata HELM posaçërisht gjatë kompletimit të fazës dizajnuese të projektit të tyre. Qëllimi kryesor i takimeve ishte që të sigurohet që të dy ekipet kuptojnë funksionet dhe aktivitetet e secilës projekt, dhe të zhvillojë marrëdhënia të mira punuese në mënyrë që projektet të jenë të barabarta e jo konkurruese.

4 REZULTATET KRYESORE TË ARRITURA

DASHC është rishikuar dhe një divizion- Divizioni për Menaxhimin dhe Koordinimin e Administratës Publike (DMKRAP)- posaçërisht përgjegjëse për udhëheqjen e procesit të implementimit të strategjisë së RAP dhe Planit të veprimit që ishin të aprovuara, të themeluara dhe tash funksionojnë plotësisht.

Grupi Punues për Reformën e Administratës Publike (GPRAP) i propozuar është aprovuar nga Qeveria e Kosovës; është themeluar dhe tanimë funksionon duke mbikëqyrur implementimin e RAP dhe raportin e progresit për Agjencinë për Integritet Evropian (AIE) dhe Qeverisë së Kosovës.

Gjashtë nën-grupe punuese për Reformën e Administratës Publike (nën- GPRAP) janë themeluar dhe janë takuar që të drejtojnë implementimin nga Ministrinë të aktiviteteve në Planin e Veprimit të RAP.

Procesi i raportimit për implementimin e Planit të Veprimit të RAP ka filluar dhe raportet e para janë dorëzuar tek GPRAP dhe Ministres për Shërbime Publike.

Shërbimet e Sekretariatit (bërja e agjendave, ftesa e pjesëmarrësve dhe procesverbali) për GPRAP dhe nën-GPRAP janë duke funksionuar përbrenda DASHC dhe DMKRAP duke përdorur formatet dhe mënyrën e raportimit të standardizuara .

Një këshilltar ndërkombëtar është caktuar nga UNDP-KFOS Fondi për ndërtim kapacitetesh për të mbështetur Drejtorin e DASHC, posaçërisht për implementimin e strategjisë së Reformës së Administratës Publike.

Çdo ministri e ka caktuar koordinatorin për RAP përgjegjës për të siguruar që ministrinë e tyre përfshijnë kërkesat e strategjisë dhe planin e veprimit të RAP nëpër plane dhe programe të punës; dhe DMKRAP ka filluar ti vendosë këta Koordinator në rrjetin mbështetës.

Kryesuesi i GPRAP- Sekretari Permanent i MSHP-së- raporton për progresin e implementimit të Planit të Veprimit të RAP tek takimet javore tek të gjithë Sekretarët Permanent, në këtë mënyrë të angazhojë të gjitha ministrinë në nivelin më të lartë të shërbimit civil në programin e reformës.

Një muaj të tërë një fushatë publicitare është organizuar për adresimin e njerëzve dhe shërbyesve civil. Fushatë, e cila ka përfshirë televizionin, gazetatat dhe billboardat reklamuese, dhe ngjarje të ndryshme, dhe ngjarje, të cilat qartë i theksojnë objektivat e RAP- qasja në shërbimet publike më të shpejta, lira dhe me kualitet më të lartë për qytetarët.

5 REKOMANDIMET PËR AKTIVITETET E ARDHSHME TË QEVERISË

Ekipi mbështetës i DFID-RAP rekomandon veprimet vijuese që të ndermirën nga MSHP dhe GPRAP gjatë 3 deri muajt e ardhshëm:

- Të vazhdojë ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimi dhe fuqizimi i divizionit të ri të DASHC (DMKRAP), përbrenda DASHC, kështu që është i paraparë që të jetë ekspertiza qendrore dhe fuqia kryesore për shtyrjen e implementimit efektiv të programit të RAP.
- Zhvillon dhe implementoj masat e hollësishme dhe indikatorët për të gjithë të dalurat nga Plani i Veprimit, për të përmirësuar dhe të bëjë më shumë relevante vlerësimin, monitorimin dhe raportimin nga ministrinë, GPRAP dhe nën-GPRAP.
- Të ndermirët një rishikim gjithëpërfshirës për të themeluar pozitën e tanishme në progresin e implementimit të Planit të Veprimit të RAP, posaçërisht në ato aktivitete të identifikuar për 2007 dhe fillimi i vitit 2008, dhe të prezantojë propozimin tek GPRAP duke azhurnuar Planin e Veprimit të RAP. Edhe pse progresi është arritur nga ministrinë duke kryer disa nga veprimet e kërkuara, në disa raste kjo do të ishte për shkak të punës së tyre ditore në ministri.
- Të kërkojë nga të gjitha ministrinë që të bëjë programet e punës të hollësishme, ndoshta duke përdorur kornizën logjike apo metodologjinë e ngjashme, për secilën nga veprimet për të cilët ata janë përgjegjës për azhurnimin e Planit të veprimit të RAP.
- Identifikojë dhe planifikojë së si implementimi i vazhdueshëm i strategjisë dhe planit të veprimit të RAP dhe implementimi i të dalurave të (shpejt të fillojë) projekti i Rishikimit Funkcional, po ashtu projekt i financuar nga DFID, do të menaxhohej nga procesi i unifikuar